



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QENDRA KULTURORE DHE KLUBI I SPORTIV LUSHNJE
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Lushnje më, ____/____/2024

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës – Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje skene”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **Kodet CPV45237000-7 , 39112000-0**

VLERA E FONDIT LIMIT TOTAL /VLERA E PRITSHME E KONTRATAVE: **1 829 680 (një milion e tetëqind e njëzet e nëntë mijë e gjashtëtëqind e tetëdhjetë) lekë pa T.V.SH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të V.K.M. Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Qendra Kulturore dhe Klubi Sportit Lushnje ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim ofertë, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilën është e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të V.K.M. Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

b. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;

Argumentimi: Ky kriter u vendos bazuar në nenin 76 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, dhe nenin 26 të V.K.M. Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 Sipas kriterëve të përgjithshme të Pranim/Kualifikimit

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin

2.2.1 Kopje të deklaratës së xhiros mesatare vjetore të dy viteve të fundit (2022,2023) lëshuar nga Administrata Tatimore, e cila duhet të jetë 40% e vlerës së parashikuar të kontratës.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky vërtetim duhet të paraqitet nga secili prej pjestarëve të bashkimit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77 te Ligjit nr. 162/2020 **“Për Prokurimin Publik”** i ndryshuar, në të cilin gjejmë të percaktuar se: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilanci të tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës.; në pikën 1 dhe pikën 2/c të nenit 43 të V.K.M.-së nr. 285, datë 19.05.2021 **“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”**, ku përcaktohet se: Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/c: 2. *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar;**

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të O.E. ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga A.K.

2.2.2. Kopje të certifikuara të bilancit të konfirmuar me vulë pranë Autoriteteve Përkatëse (Administrata Tatimore) të dy viteve (2021,2022) të fundit që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter duhet të plotësohet nga çdo anëtar i bashkimit sipas legjislacionit tatimor në fuqi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 **“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”**.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në ligjin nr.25/2018 **“Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”**.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Punë të ngjashme (e cila provon përvojën e mëparshme) për shërbime të ngjashme në një vlerë jo më të madhe se 20 % të vlerës së përlloritur të kontratës, që prokurohet, dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës,

ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 **“Për Prokurimin Publik”** i ndryshuar dhe nenit 55, pika 4(b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 **“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”**. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë fotografi/ katalogë/ broshurë ose fragmente (faqe) të katalogut/eve për pajisjet e mësipërme, duke markuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme pajisje që përfton, me specifikimet përkatëse të markuara, në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria me kërkesat në DST.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 **“Për Prokurimin Publik”** i ndryshuar dhe nenit 40, pika 6 dhe 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 **“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”**, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të garantojnë A.K. që do të furnizojë do të jenë origjinale e cilësore.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike dhe termat e referencës janë hartuar nga grupi i punës.

Në hartimin e specifikimeve teknike, nuk është përmendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve.

Çdo karakteristikë e përcaktuar në specifikime teknike, për mallart objekt prokurimi, janë përshkruar në mënyrë të tillë që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me nenin 4, pika 34/b dhe nenin 36 të L.P.P., si edhe nenin 40, pika 2 . të V.K.M. Nr. 285 datë 19.05.2021 **“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”**.

Afati i realizimit prej 60 ditësh nga momenti i nënshkrimit të kontratës është vendosur duke u bazuar në studimin e tregut dhe domosdoshmërinë për realizimin në kohë të procedurës,si edhe me qëllimin për të realizuar furnizimin me mallrat e kërkuar brenda një afatii të arsyeshëm.

Kriteret e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga specialistët e fushës pjesë e njësisë së prokurimit.

Njësia e Prokurimit